



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "LevelMax" Sh.P.K. të datës 23.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 18.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-12647-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "LevelMax" Sh.P.K. të datës 23.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 18.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-12647-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "LevelMax" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.12.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-12647-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Faqe 1 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

P.1. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar as deklaratat tatimore dhe as raportet financiare por vetëm qarkullimin bankar prandaj nuk ka përmbushur kërkesën e DT lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare.

P.2. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar është dashur të prezentoj 19 punonjës mirëpo ka prezentuar vetëm 15 punëtor.

P.3. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar aneksin 7 të plotësuar lidhur me afatin e implementimit dhe periudhën garantuese.

P.4. dhe P.5. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar vërtetimin e ATK për borxhet, vërtetimin për falimentim dhe për të kaluarën penale.

P.6. - Ky pretendim i parashtruesit i referohet arsyes eliminuese nga AK ku përcaktohet se parashtruesi si lider të GOE ka përcaktuar OE Qëndrim Gubetini i cili nuk e plotëson kërkesën e DT për 60% të realizimit të kontratave në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë. Parashtruesi pretendon se lider nuk është Qëndrim Gubetini por LevelMax.

P.7. - Ky pretendim i parashtruesit i referohet arsyes eliminuese nga AK ku përcaktohet se nuk janë dorëzuar me ofertë dëshmitë e kërkuara dokumentare lidhur me pajisjet. Parashtruesi pretendon se pajisjet i ka dorëzuar në listë ndërsa për dëshmitë dokumentare AK është dashur që të kërkoj sqarime shtesë.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se të gjitha pretendimet janë të pabazuara dhe në këtë rast i është faluar besimi i plotë vlerësimit të komisionit vlerësues pasi që argumentet e prezantuara nga parashtruesi nuk janë të bazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 27.12.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.